



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 35/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit Dardania, Nr. 3522/21H datë 01.11.2021 për akreditim të programeve të studimit:
- Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS (Riakreditim);
  - Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS (Riakreditim);
  - Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS (Riakreditim);
  - Infermieri, BSc, 180 ECTS (Akreditim); dhe
  - Administrim Publik, MA, 120 ECTS (Riakreditim).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m i

Kolegji Dardania ka parashtruar kërkesë (Nr. 3522/21H datë 01.11.2021) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit: 1) Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS (Riakreditim); 2) Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS

1/4

(Riakreditim); 3) Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS (Riakreditim); 4) Infermieri, BSc, 180 ECTS (Akreditim); dhe 5) Administrim Publik, MA, 120 ECTS (Riakreditim).

Bazuar në pikën 1.2 të Nenit 10 të UA për Akreditim ku thuhet, *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stofit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së"*, KShC në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Universitet.

Sipas të dhënave të prezantuara nga raporti përmbledhës për programet për të cilat ka aplikuar ky institucion, dhe pas analizimit të detajuar të dokumentacionit të prezantuar për stafin akademik, ashtu siç parashihet me Nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, dhe bazuar në Nenin 10, pika 1.3.2 të tij, KShC mori vendim për refuzim të aplikacionit për programet si në dispozitiv të këtij vendimi.

- **Për programin Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS** (Riakreditim), institucioni ka paraparë si bartës të programit: Mariela Lazi (PhD në Psikologji), Ferit Hysa (PhD në Shkenca Sociale – Psikologji dhe Pedagogji), dhe Krenar Ahmeti (PhD në Psikologji).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve"*.

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se asnjëri nga titujt PhD i bartëseve Mariela Lazi, Ferit Hysa dhe Krenar Ahmeti nuk e mbulojnë pjesën e studimeve menaxheriale të programit.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale, BA, 180 ECTS (Riakreditim).

- **Për programin Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS** (Riakreditim), institucioni ka paraparë si bartës të programit: Selema Allamani - Dushku (PhD në Punë Sociale), Rezak Jakupi (PhD në Shkenca të Sociologjisë), dhe Lon Laska (PhD në Shkenca Sociale – Psikologji dhe Pedagogji).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve"*.

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se asnjëri nga titujt PhD i bartëseve Rezak Jakupi dhe Lon Laska nuk i përkohet fushës së programit të studimit.



Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS (Riakreditim).

- **Për programin Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS (Riakreditim),** institucioni ka paraparë si bartës të programit: Muazam Halili (PhD në Studime të Sigurisë), Afrim Jusufi (PhD në Shkenca Politike dhe Administratë Publike), Mentor Agani (PhD në Shkenca Sociologjike), Njomza Krasniqi (PhD në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare), dhe Arsim Dragaj (PhD në Siguri Kombëtare).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve”.*

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se titujt PhD i bartëseve Muazam Halili, Mentor Agani, Njomza Krasniqi dhe Arsim Dragaj nuk i përkojnë fushës së programit të studimit, dhe asnjëri nga bartësit nuk e mbulojnë fushën e Administratës Publike siç është cekur në emrin e programit.

Gjithashtu, bartësi Muazam Halili nuk e ka ngarkuar dëshminë nga administrata tatimore nga vendi i tij i origjinës në platformën e-akreditimi siç kërkohet për shtetasit e huaj.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Shkenca Politike dhe Administrim Publik, BA, 180 ECTS (Riakreditim).

- **Për programin Infermieri, BSc, 180 ECTS (Akreditim),** institucioni ka paraparë si bartës të programit: Shkelzen Elezaj, Albert Lila, Mazllom Smajli dhe Gazmend Jusufi.

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve”.*

Pas verifikimit të stafit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se asnjëri nga bartësit të lartë cekur nuk janë deklaruar në platformën e-akreditimi dhe KShC nuk i posedon dëshmitë e kërkuara për të bërë vlerësimin e aplikacionit të këtij programi.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS (Riakreditim).

- **Për programin Administrim Publik, MA, 120 ECTS (Riakreditim),** institucioni ka paraparë si bartës të programit: Llokman Mirtezani (PhD në Studime Evropiane për Integritet), dhe Bajram Ibraj (PhD në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare).

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, kërkohet që: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë që për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimeve".*

Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se asnjëri nga titulli PhD i bartësit Bajram Ibraj nuk i përkon fushës së programit të studimit.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit adekuat, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të refuzojë aplikacionin për programin e studimit Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale, BA, 180 ECTS (Riakreditim).

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Dardania;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hashim Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

